



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument Parlamentar*

*Tiranë, më 21.07.2020*

**RAPORT**

**PËR**

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 11444, DATË 02.03.2020, PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 15/2020 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, « PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË », TË NDRYSHUAR**

**I. Hyrje**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21.07.2020, mori në shqyrtim dekretin nr.11444, datë 02.03.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.15/2020, « Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, «Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar », për të cilin ky komision, është caktuar komision përgjegjës.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi raporte për shqyrtimin e Dekretit deputeten Klotilda Bushka (Ferhati).

Për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të dekretit, në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ishin të pranishëm: znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe z. Bledar Dervishaj dhe znj. Katrin Treska, përfaqësues të institucionit të Presidentit të Republikës.

**II. Baza ligjore për shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës**

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

*Neni 85*

*1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*

2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

## **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

### *Neni 86*

#### *Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji*

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.

3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.

5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.

6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.

7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.

8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

### **III. Arsyet për kthimin e Ligjit sipas dekretit të Presidentit të Republikës**

Me Dekretin nr.11444, datë 02.03.2020, Presidenti i Republikës vendosi kthimin e ligjit nr.15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në materialin shpjegues të dekretit, Presidenti çmon se, dispozita të veçanta të ligjit nr. 15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, çenojnë:

- 1) Parimin e sigurisë juridike;
- 2) Parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit;

- 3) Parimin e hierarkisë së normave kushtetuese dhe rezervën kushtetuese;
- 4) Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Në arsyetimin e dekretit për kthimin e ligjit nr. 15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Presidenti i Republikës ka parashtruar disa argumente ku bazon përfundimin e tij, të cilat po i parashtrorjmë si vijon:

***Argumenti 1: Parashikimi i nenit 2 të ligjit nr. 15/2020, që shton pikën 3, në nenin 37 të ligjit nr. 96/2016, si dhe parashikimi i nenit 4 të ligjit nr. 15/2020, që bën shtesa dhe ndryshime në nenin 61 të ligjit nr. 96/2016 mbi procedurën e betimit, shkel disa parime dhe dispozita të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke nisur nga neni 136 i Kushtetutës.***

*Parashikimi i një alternative të ceremonisë së betimit, duke synuar që betimi me shkrim jo në prani të një autoriteti të lartë shtetëror dhe dërgimi/postimi i tij, të kthehet në një rregull të përgjithshëm, synon të deformojë rëndë këtë institut, që tregon përgjegjshmërinë, ndërgjegjshmërinë dhe angazhimin e subjektit që merr një detyrë të rëndësishme.*

*Ndryshimet e bëra në nenin 61 të ligjit nr. 96/2016, përmes nenit 4 të ligjit nr. 15/2020, krijojnë diferencim mes momentit të nisjes së detyrës për anëtarin e Gjykatës së Lartë që zgjidhet mes juristëve të spikatur dhe atyre që vijnë nga rradhët e gjyqësorit. Gjykata e Lartë, pas ndryshimeve kushtetuese është kthyer në një Gjykatë Ligji, sipas nenit 141 të Kushtetutës, dhe pavarësisht mënyrës së përzgjedhjes apo emërimit në të, gjyqtarët që marrin detyrën në këtë Gjykatë, duhet të betohen njësoj, para nisjes së ushtrimit të këtij funksioni. Çdo parashikim i ndryshëm ligjor, krijon ndasi edhe mes vetë anëtarëve që marrin detyrën.*

*Betimi është shenjë besnikërie ndaj Kushtetutës së vendit. Betimi, është një garanci për mbajtësin e pushtetit publik – vetë shtetasit e Republikës së Shqipërisë, që lidh subjektin që merr një funksion të rëndësishëm shtetëror, me angazhimet që i janë deleguar organeve përmes Kushtetutës. Si i tillë, akti i betimit, nuk tregon vetëm për nga përmbajtja angazhimin e individit që merr detyrën për të përmbushur atë konform ligjit themeltar të shtetit dhe ligjeve të tjera në fuqi, por për nga forma, ceremoniali, pra vetë kryerja e këtij akti betimi para Kreut të Shtetit si përfaqësues i unitetit të popullit, është element thelbësor përmbajtësor, që tregon gatishmërinë dhe ndërgjegjësimin në marrjen përsipër të kësaj detyre.*

*Prania dhe zhvillimi i betimit sipas një porocedure dhe ceremoniali tek autoriteti shtetëror, në këtë rast tek Kreu i Shtetit, tregon:*

- *ndërgjegjshmërinë dhe kuptueshmërinë e personit që kryen betimin mbi veprimet që po ndërmer;*
- *krijon bindjen e Kreut të Shtetit se ky person nuk po e kryen këtë veprim duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe, çka do të sillte pavlefshmërinë e tij, si për çdo veprim tjetër juridik.*

*Betimi para Presidentit të Republikës, përveç pasojave të kërkuara institucionale për fillimin e ushtrimit të detyrës, sjell garanci morale, dhe forcim të angazhimit për mbrojtjen e detyrimeve të paraqitura në tekstin e Kushtetutës, për këta funksionarë të rëndësishëm siç janë anëtarët e Gjykatës së Lartë, apo prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.*

*Ndryshimet në nenin 61 të ligjit, mbi deformimin e procedurës së betimit, duke parashikuar për pasojë edhe momente të ndryshme të fillimit të mandatit për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që vijnë nga rradhët e juristëve të spikatur dhe prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bien ndesh me frymën e nenit 136 të Kushtetutës.*

*Betimi përpara Kreut të Shtetit, është një garanci më shumë për njohje të parimit të sovranitetit kombëtar dhe lirive e të drejtave themelore të popullit. Për rrjedhojë, anëtarët e Gjykatës së Lartë, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, njësoj si dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, që do të shërbejnë në ushtrimin e funksioneve të tyre si garant të të drejtave dhe parimeve të një shoqërie demokratike që përcaktohen në Kushtetutë, legjitimitetin që i rrjedh nga Kushtetuta, dhe vullnetin për ta ushtruar atë nuk mundet ta deklarojnë dhe ta garantojnë askund tjetër veçse para Kreut të Shtetit personalisht.*

**Argumenti 2: Neni 5 i ligjit nr. 15/2020, që shton nenin 124/1 në ligjin nr. 96/2016, bie ndesh me nenet 140, 147/a dhe 147/d, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

*Në asnjë moment, sipas normës kushtetuese, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk i është dhënë tagri për të kryer verifikimin e pasurisë. Verifikimi i pasurisë dhe figurës, për magjistratët në detyrë, është zgjidhur me ligjin e posaçëm për rivlerësimin kalimtar, në zbatim të parashikimeve kushtetuese. Ndërsa për kandidatët për gjyqtarë apo prokurorë, verifikimi paraprak i pasurisë dhe figurës së tyre, bëhet si në momentin e fillimit të Shkollës së Magjistraturës, ashtu dhe pas përfundimit të saj dhe para emërimit sipas ligjit (neni 135 dhe neni 148/ç i Kushtetutës). Ky verifikim kryhet në mënyrë të detajuar nga Këshillat përkatës, siç përcakton dhe neni 32 i ligjit nr. 96/2016.*

*Përveçse është ky parashikim në tejkalim të kompetencave kushtetuese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe mbivendos kompetencat e Këshillave, një parashikim i tillë nuk përputhet as me konceptin e nisjes së një procesi hetimor, sipas kuptimit që i ka dhënë vetë ligjit nr. 96/2016. Parashikimi i një procedure të tillë dhe dhënia e kompetencës Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është gjë tjetër veçse shndërrimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, nga një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme, në një mjet të përhershëm, që rrezikon në mënyrë flagrante pavarësinë e gjyqtarëve dhe parimin e palëvizshmërisë në detyrë të tyre, shmangien e magjistratëve nga detyra gjer në kapjen politike të sistemit nga forca që kontrollon procesin, pra që ka emëruar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.*

**Arsyetimi 3: Neni 8, i ligjit nr. 15/2020, që ndryshon nenin 152 të ligjit nr. 96/2016, është në shkelje të neneve 42, 140, 145, 147/a dhe 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

*Një parashikim i tillë, shmang hetimin që i paraprin fazës së fillimit të procedimit disiplinor, dhe referon në një vendimmarrje të kryer në kushtet e urgjencës, që dukshëm ul garancitë procedurale mbrojtëse të magjistratit. Një parashikim i tillë, shoqëruar me parashikimin antikushtetues që propozohet të shtohet përmes dispozitës 124/1, që i lejon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të kryejë verifikim të pasurisë, krijon problematika të rënda pasi:*

- Përveçse mbivendos kompetencat e disa organeve kushtetuese, siç janë organet e rivlerësimit kalimtar, dhe Këshillat sa i takon procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës për magistratët e rinj dhe për vijimin e ruajtjes së standartit të pasurisë dhe figurës në të ardhmen;
- Krijon edhe skenarin e mundshëm për t'u përdorur në mënyrë selektive për të gjithë ata magistratë që ende nuk kanë kaluar procesin e vettingut, ose edhe ata që e kanë kaluar me sukses atë, por që me vendimmarrjet e tyre kanë treguar se janë të paanshëm dhe të pandikueshëm nga presioni politik.

Parashikimi i nenit 152 të ligjit nr. 15/2020, shkel hapur këtë garanci kushtetuese që i është njohur gjyqtarit në funksion të ruajtjes së pavarësisë dhe paanësisë së tij, duke bërë që pezullimi të bëhet ende pa nisur procedimi disiplinor, por vetëm me një hetim të kryer për 3 ditë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ky hetim i kryer në këtë afat kohor 3 ditor, nuk duket se ofron garanci për ndjekjen e procesit të rregullt, i cili kërkon që shkelja të hetohet me mjetet dhe afatet e duhura nga organi i ngritur nga Kushtetuta për këtë qëllim – Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Ndërsa parashikimet e ligjit nr. 15/2020, ndryshojnë detyrën kushtetuese të ILD-së për të hetuar, duke sanksionuar në këtë rast se, nuk ka nevojë për hetim. Ligji e shton më tepër paqartësinë sepse dublon pa asnjë shkak Kodin e Procedurës Penale për dy arsye: a) Kodi i Procedurës Penale përcakton procedura të sakta hetimore për krimet, ku përfshihen edhe masat e sigurimit, një prej të cilave është pezullimi nga detyra, që e vendos gjykata dhe nuk ka nevojë për investimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të Këshillit; b) Një prej risive që solli Ligji nr. 96/2016 është marrëdhënia që ekziston midis procedimit penal dhe procedimit disiplinor, ku merr përparësi procedimi penal, pasi ligji parashikon që procedimi disiplinor pezullohet gjersa procedimi penal të zgjidhet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Paraqitja nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, para Këshillit, e kërkesës për pezullimin e magistratit nga detyra siç parashikohet në ndryshimet që i bëhen nenit 152 të ligjit nr. 96/2016, nëpërmjet nenit 8 ligjit nr. 15/2020, tejkalojnë në mënyrë flagrante dispozitën Kushtetuese të nenit 147/d , paragrafi 1, si dhe janë në shkelje të hierarkisë së akteve ligjore në fuqi të parashikuara në nenin 116 të Kushtetutës.

Ky ligj rifut mundësinë e pezullimit diskrecional të magistratit përpara fillimit të një procedimi disiplinor, kamufluar nën një titull tjetër, edhe pse kjo masë e parashikuar në ligjin fillestar nr. 96/2016 është shfuqizuar me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara me ligjin nr. 15/2020 shmangen procedurat e përcaktuara në nenin 138, të ligjit nr. 96/2016, duke e rikthyer pezullimin mbi bazë diskrecioni, që ishte parashikuar fillimisht në ligjin nr. 96/2016 dhe që u shfuqizua me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Ndërkohë, parashikimet e ligjit nr. 15/2020, që synojnë të zgjerojnë në mënyrë antikushtetuese kompetencat e ILD-së.

Këto propozime të sjella me ligjin nr. 15/2020, përveçse tejkalojnë kërkesat kushtetuese dhe u mungon qartësia, shkelin edhe qëndrueshmërinë që duhet të kenë dispozitat ligjore.

***Argumenti 4: Ligji nr. 15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, bie ndesh me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.***

*Ndryshimet ligjore të miratuara nuk kanë marrë parasysh parashikimet e nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë duke tejkaluar hierarkinë e normave juridike, pasi ligjet që dalin për zbatim të një norme kushtetuese nuk mund të tejkalojnë kriteret të cilat vetë norma Kushtetuese i ka parashikuar në dispozitat e saj. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.*

***Argumenti 5: Ligji nr. 15/2020, ka shmangur procesin e konsultimit dhe ka cënuar parimin e sigurisë juridike.***

Në përfundim Presidenti i Republikës ka vendosur kthimin në Kuvend të ligjit nr.15/2020 për rishqyrtimin e neneve 2, 4, 5, dhe 8 të ligjit, me qëllim që çdo ndryshim në ligjin nr. 96/2016, të jetë në respektim të frymës dhe gërmës së Kushtetutës dhe vendimit nr. 34, datë 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

#### **IV. SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT**

Gjatë shqyrtimit të dekretit në Komisionin për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e institucionit të Presidentit parashtruan argumentet për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ministrja e Drejtësisë, sqaroi se qëllimi i nismës është qartësimi i institutit të betimit të magjistratëve, të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nga rradhët e juristëve të spikatur dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, duke respektuar në frymë dhe në gërmë parashikimet kushtetuese. Njëkohësisht, Ministrja e Drejtësisë, sqaroi se qëllimi i këtyre ndryshimeve lidhet me parashikimin e mekanizmave të nevojshëm në dispozicion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për t’iu përgjigjur rasteve kur magjistratët kryejnë veprime që diskreditojnë rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

Relatorja solli në vëmendje të anëtarëve të Komisionit se në funksion të transparencës dhe gjithpërfshirjes, pas përfshirjes së projektligjit në Programin e Punës dhe Kalendarin e Punimeve të Kuvendit, ligji nr.15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar një procesi konsultimi dhe marrje opinionesh jo vetëm nga institucionet e sistemit të drejtësisë por edhe nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë.

Ligji i është përcjellë për opinion Këshillit të Emërimeve në Drejtësi; Prokurorisë së Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shoqatës së Gjyqtarëve; Shkollës së

Magjistraturës; Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës; Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Fondacionit SOROS, Qendres “Res Publica”, Institutit të Studimeve Politike dhe USAID, duke u lënë në dispozicion një afat 10 ditor për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve.

Bazuar në nenin 93 dhe 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë japin mendim për projektligjet ose për çështje të tjera që mund të ndikojnë mbi sistemin gjyqësor/prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi.

Paralelisht me kërkesën për dhënien e mendimeve është ngritur edhe një grup pune me përfaqësues të organeve të reja të sistemit të drejtësisë (Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë), Ministrisë së Drejtësisë, nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS V. Në këto mbledhje ka marrë pjesë edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për problematika të lidhura funksionimin e këtij institucioni.

Për sa më lart, ligji është jo vetëm një nismë, e cila i është nënshtruar një procesi konsultimi publik, por përbën edhe një nismë e cila i është nënshtruar një diskutimi të gjërë në grup pune me përfaqësues të organeve të reja të sistemit të drejtësisë, nën asistencën e ekspertëve të misionit EURALIUS V, për të arritur në variantin e shqyrtuar në komisionin përgjegjës për çështjet ligjore dhe të miratuara më pas nga seanca plenare.

Procesi i konsultimit publik të nismave ligjore, përbën një traditë të konsoliduar në Kuvendin e Shqipërisë. Përgjigja ose jo, apo zgjedhja për të kthyer përgjigje e institucioneve apo organizatave të shoqërisë civile, që ftohen të japin mendim nuk e pengon punën dhe nuk e cënon procesin e konsultimit. Jo çdo mendim që vjen është një mendim që domosdoshmërisht është njëqind për qind i drejtë ose i gabuar. Është Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore që në përfundim të procesit të konsultimit vlerëson se cila do të jetë zgjedhja e duhur, në ushtrim të kompetencave ligjvënëse.

Për sa i takon adresimit të problematikave të tjera të paraqitura nga Këshillat, ashtu siç është argumentuar edhe në raportin e komisionit përgjegjës që ka shoqëruar nismën ligjore në fazën e miratimit të saj, relatorja ritheksoi mbështetjen maksimale për adresimin e këtyre problematikave dhe gadishmërinë për të mbështetur ndërhyrjet e mëtejshme në ligjet e reformës në drejtësi, por këto ndryshime ndryshime paraprakisht do t'i nënshtrohen një analize të plotë mbi problematikën, efektet, pritshmëritë në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe nën asistencën e partnerëve ndërkombëtare të misionit EURALIUS V dhe OPDAT.

Në përfundim, relatorja solli në vëmendje se, perceptimet e qëllimeve të nismës të ndryshme nga ajo që nismëtarët kanë parashtruar në argumentet e tyre, nuk i shërbejnë frymës së luajalitetit institucional dhe nuk janë në dobi të procesit ligjvënës.

**Lidhur me çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit të Republikës, relatorja paraqiti argumentet dhe vlerësimet për arsyet e parashtruara si më poshtë vijon:**

***Së pari: Në lidhje me argumentin se parashikimi i nenit 2 të ligjit nr. 15/2020, që shton pikën 3, në nenin 37 të ligjit nr. 96/2016, si dhe parashikimi i nenit 4 të ligjit nr. 15/2020, që bën shtesa dhe ndryshime në nenin 61 të ligjit nr. 96/2016 mbi procedurën e betimit, shkel disa parime dhe dispozita të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke nisur nga neni 136 i Kushtetutës, sqarojmë se:***

Ligji nr. 15/2020 parashikon ndryshime në përmbajtjen e nenit 37 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet kësaj dispozite, parashikohet që ceremonia e betimit të magjistratit të bëhet para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këto organe duhet që jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit të organizojnë ceremoninë e betimit. Dispozita parashikon se pas përfundimit të këtij afati, magjistrati kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të tij me shkrim pranë organit të emërtesës konsiderohet si dita e fillimit të detyres së magjistratit.

Propozimi i kësaj dispozitë në ndryshim nga sa argumenton Presidenti i Republikës në dekretin e tij nuk çënon asnjë parashikim kushtetues. Kushtetuta në asnjë nen të saj nuk ka parashikuar institutin e betimit të magjistratit, dhe aq me pak organin përpara të cilit të mund të bëhet ky betim.

Për rrjedhojë, rregullimi i institutit të betimit të magjistratit është bërë në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar. Është pikërisht ky ligj që në nenin 37 të tij përcakton vetëm formulën e betimit duke mos parashikuar organin përpara të cili bëhet ky betim. Në këtë aspekt ndryshimet e miratuara në përmbajtjen e nenit 37 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë parashikuar që ceremonia e betimit të magjistratit të bëhet para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke specifikuar edhe afatin brenda të cilit realizohet ky akt solemniteti, i cili është i lidhur me fillimin e ushtrimit të detyrës nga magjistrati. Ligji parashikon edhe mekanizmin zhblllokues, sipas të cilit në rast se pas kalimit të këtij afati, këshilli nuk thërret magjistratin e emëruar prej tij për të kryer betimin, ky i fundit e kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndryshimi i miratuar në nenin 37 nuk ka asnjë qëllim tjetër veçse të sigurojë qartësinë e plotë juridike në zbatimin e normës ligjore. Këto ndryshime parashikojnë që të jetë vetë organi i cili vendos për emërimin e kandidatëve të diplomuar dhe për caktimin e tyre në detyrë, ai që do të realizojë edhe ceremoninë e betimit. Ceremonia e betimit nuk duhet të shikohet si një funksion thelbësor i Këshillave, ai është një funksion ceremonial i tij, në funksion të kompetencave kushtetuese që Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar i ka atribuar Këshillave pikërisht atë të emërimit të magjistratëve (nenin 147/a (pika 1/a) dhe 149/a (pika 1/a)) të Kushtetutës. Vendosja e një afati për realizimin e ceremonisë së betimit dhe parashikimi i një mekanizmi zhblllokues pra realizimi i tij me shkrim dhe dërgimi pranë Këshillave jo vetëm nuk çënon në asnjë moment parashikimet kushtetuese por përkundrazi i shërben sigurimit të funksionalitetit në ushtrimin e detyrës nga magjistratët e emëruar në përputhje me parimet e pavarësisë së gjyqësorit në funksion të një sistemi drejtësie,



të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur lidhur me rëndësinë e betimit të anëtarëve të organeve kushtetuese, si një shprehje e vullnetit për të marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësit kushtetuese të funksionit. Në Vendimin e saj nr.44/2011 ajo ka mbajtur qëndrimin se: *“ . Betimi është një akt që shërben për të deklaruar vullnetin, gatishmërinë, bindjen dhe vendosmërinë e mëtejshme të deputetit të mandatuar për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit në Kuvendin e ri, në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë qëllim. Betimi nuk është kusht për të bërë të vlefshëm mandatin e deputetit, pasi këtë e ka bërë komisioni zgjedhor, i cili e ka shpallur atë fitues nga votat e marra prej zgjedhësve. Mosbërja e betimit përbën një nga shkaqet e humbjes së mandatit parlamentar . Ky parashikim është bërë edhe për raste të tjera të fillimit të detyrës si p.sh nga Presidenti i Republikës , gjyqtarët, etj.”*

Në njëjtat argumente vlejné edhe për nenin 4 të ligjit nr. 15/2020 i cili ndryshon nenin 61 të ligjit aktual nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar duke rregulluar betimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë që përzgjidhen mes juristëve të spikatur, dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Edhe në këtë aspekt, përcaktimi i një afati për realizimin e ceremonisë së betimit, si edhe parashikimi i mekanizmit zhbllokues, pra realizimi me shkrim i betimit dhe dërgimi i tij disa organeve të parashikuara nga ligji, siguron funksionimin normal të këtyre organeve kushtetuese.

Edhe në këtë rast për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që vijnë nga rradhët juristëve të spikatur (jogjyqtarë) parashikohet që ceremonia e betimit të organizohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi që i propozon Presidentit të Republikës emërimin e kandidatit për gjyqtar të Gjykatës së Lartë. Siç argumentuam edhe më sipër edhe në këtë rast nuk çënohet në asnjë moment neni 136 i Kushtetutës, pasi kjo dispozitë kushtetuese nuk parashikon as në gërmë dhe as në frymë të saj institutin e betimit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe as organin përpara të cilit realizohet ky betimi.

Ndërkohë duke marrë në konsideratë që për një kategori magjistratësh siç janë anëtarët e Gjykatës së Lartë që vijnë nga rradhët e gjyqtarëve apo prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme, betimi tyre është bërë një herë, në momentin e emërimit dhe caktimit të tyre në pozicionin e magjistratit, për këtë arsye ngritja në detyrë si anëtar të Gjykatës së Lartë apo Prokuror të Prokurorisë së Posaçme, është vlerësuar se nuk kërkon një ceremoni të veçantë të kryerjes së aktit të betimit, për sa kohë që ligji nr. 96/2016 ka parashikuar që kalimi në këto detyra do të bëhet nëpërmjet nëpërmjet sistemit të karrierës dhe procedurës së ngritjes në detyrë.

Për sa i takon betimit të Prokurorit të Përgjithshëm formulimi i bërë në nëpërmjet nenit 4 të ligjit 15/2020 siguron harmoni të plotë me parashikimet e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, i cili përcakton në nenin 36 betimin e Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Shqipërisë.

Nenet 2 dhe 4 të ligjit nr. 15/2020 nuk cënon në asnjë moment as rekomandimet e dhëna në opinionin e Komisionit të Venecias pasi lidhur me procedurën e bërjes së betimit<sup>1</sup>. Komisioni i Venecias, nëpërmjet Opinione Nr.978/2020, të datës 19 qershor 2020 shprehur se: “Nëse shihet e nevojshme për të shmangur bllokimin në raste të qarta abuzimi, dispozitat e miratuara së fundi, por që ende nuk kanë hyrë në fuqi, për mekanizmin automatik të bërjes së betimit duhen zëvendësuar me një dispozitë të formuluar më qartë, e cila duhet miratuar në nivel kushtetues.”

Ky rekomandim i referohet nenit 129 të Kushtetutës, dispozitë që parashikon betimin e gjyqtarëve kushtetues ndërsa për betimin e magistratëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që vijnë nga rradhët e juristëve të spikatur dhe Prokurorit të Përgjithshëm siç edhe e kemi argumentuar më sipër nuk kemi një parashikim të nivelit kushtetues për institutin e betimit të këtyre funksionarëve.

***Së dyti: Në lidhje me argumentin se neni 5 i ligjit nr. 15/2020 që parashikon shtimin e nenit 124/1 “Verifikimi i pasurisë dhe figurës”, përbën një parashikim në tejkallim të kompetencave kushtetuese të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe mbivendos kompetencat e Këshillave sqarojmë se:***

Bazuar në nenin 147/d pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Ndërkohë që ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë procedurën e hetimit disiplinor, duke parashikuar afatet e parashkrimit të hetimit të shkeljes disiplinore, afatet e procedimit të shkeljes, procedurën e paraqitjes së ankesave pranë këtij Inspektori, kriteret për pranueshmerinë e ankesës, shqyrtimi fillestar, vlerësimi dhe verifikimi i ankesës, vendimi që Inspektori merr për fillimin e hetimit bazuar në ankesë ose kryesisht, zgjerimi ose ndryshimi i objektit të hetimit, rastet e pezullimit të hetimit, të drejtat dhe detyrimet e magistratit gjatë hetimit, ecuria e hetimeve, marrja në pyetje e magistratit ose e dëshmitarëve, marrja e provave që i shërbejnë hetimit nga institucione të tjera, dokumentimi dhe mbyllja e hetimit, zgjidhja me marrëveshje të përbashkëte shkeljes disiplinore që i atribuohet magistratit.

Në funksion të kryerjes së hetimit disiplinor, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar i ka dhënë të drejtën inspektorëve që:

- Të kryejnë verifikime dhe hetime administrative rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore;
- Të mbledhin të dhëna dhe vlerësojnë çdo informacion ose akt që çmojnë se është ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me Kodin e

---

<sup>1</sup> Paragrafi 106 i Opinione Nr.978/2020 të Komisionit të Venecias

Procedurave Administrative dhe ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Të hyjnë në ambientet ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet e procedimit disiplinor, të inspektojnë, të kopjojnë, shumëfishojnë dhe marrin çdo informacion ose dokument të nevojshëm për kryerjen e detyrës.
- Të mund të kërkojnë nga çdo person fizik a juridik ose institucion publik informacion, dokumente, dëshmi me gojë ose me shkrim mbi çdo çështje që lidhet me objektin e verifikimit, hetimit ose inspektimit që është duke u kryer.

Parashikimi i kësaj dispozite shtesë, e cila i jep të drejtën Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve, të kërkojë informacion nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, Policia e Shtetit, organet e administratës tatimore dhe doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës të magjistratit si dhe çdo institucion tjetër kompetent për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkelje tjetër disiplinore, ka si qëllim vetëm të detajojë të funksion të parimit të qartësisë juridike, të drejtën e inspektorit që të kërkojë informacion në disa institucione shtetërore të cilat funksionojnë mbi bazën e ligjeve të posaçme. Kjo e drejtë për marrje informacioni lidhet ngushtësisht dhe është në funksion të plotë të kompetencave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hetimin e shkeljeve disiplinore. Qëllimi i këtij neni nuk është dublikimi i kompetencave të Këshillave të cilat në bazë të nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e pasurisë dhe të kandidatëve që pranohen në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe përpara emërimit në detyrë. Njëkohësisht kjo dispozitë nuk as si qëllim të mbivendoset me kompetencat e organeve të rivlerësimit kalimtar të cilat kanë funksioneve të specifikuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”. Synimi i këtij neni lidhet vetëm me të drejtën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të marrë informacion nga organet e listuara në këtë nen dhe vetëm në funksion të hetimit disiplinor. Bazuar në nenin 123 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. E drejta e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të kërkuar informacion pranë institucioneve të parashikuara në nenin 5 të ligjit, do të shërbejë për ofrimin e garancive të nevojshme me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe gjithanshëm disiplinor duke respektuar njëkohësisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor të subjektit që i nënshtrohet procedurës hetimore.

***Së treti: Në lidhje me argumentin se neni 8, i ligjit nr. 15/2020, që ndryshon nenin 152 të ligjit nr. 96/2016, është në shkelje të neneve 42, 140, 145, 147/a dhe 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.***

Qëllimi i kësaj dispozite ligjore sië është sqaruar edhe në raportin e komisionit përgjegjës për çështjet ligjore është rikthimi i besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe organin e prokurorisë, i cili ka përbërë edhe një nga prioritetet kryesore të reformës në drejtesi.

Parashikimi i mundësisë së Këshillave për të pezulluar magjistratin nga detyra, kur vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit është një mekanizëm ligjor i parashikuar dhe i njohur në disa vende të Bashkimit Evropian.

Formulimi i këtij neni vjen në harmoni me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni i Venecias, i cili në opinionin e tij CDL-AD(2017)018, (Opinion mbi ligjin e sistemit gjyqësor në Bullgari) shprehet se:

*“...Komisioni i Venecias pranon që një gjyqtar, kundër të cilit janë dërguar akuza serioze, mund të pezullohet nga detyrat. Sidoqoftë, duhet t'i përkasë Dhomës Gjyqësore të verifikojë se sa serioze dhe të bazuara janë këto akuza. Në versionin aktual të nenit 230, Dhoma Gjyqësore e SJC duket se kryen vetëm një rol zyrtar të aprovimit të pezullimit sa herë që prokuroria ka filluar mekanizmin sipas nenit 230. Në vend të kësaj, ligji për sistemin gjyqësor duhet të përcaktojë qartë se Dhoma Gjyqësore duhet të rishikojë përmbajtjen e akuzave dhe të vendosë nëse provat kundër gjykatësit janë mjaft bindëse (pa qenë domosdoshmërisht "përtej dyshimit të arsyeshëm") dhe nëse ka vend për pezullim. Kur e bën këtë, Dhoma Gjyqësore e SJC duhet të jetë në gjendje të përcaktojë afate të shkurtra kohore për hetime kundër gjyqtarëve të pezulluar.”*

Kjo dispozitë është në harmoni edhe me Notën shpjeguese të publikuar nga OSBE “Mbi standartet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të procedimit disiplinore ndaj gjyqtarëve” e cila argumenton se:

*“...Në rrethana të jashtëzakonshme dhe serioze, një gjyqtar i paditur mund të pezullohet nga puna gjatë fazës së hetimit - kjo është më pak disiplinore, dhe më shumë një masë e përkohshme, paraprake. Masat e tilla do të justifikohen vetëm nga natyra dhe rëndësia e veprës së pretenduar dhe / ose nëse pezullimi i gjykatësit mund të rrezikojë integritetin ose pavarësinë e tij / saj. Pezullimet e tilla në asnjë mënyrë nuk duhet të paragjykojnë rezultatin e procedurave. Kështu, ndërsa pezullohen, gjyqtarët duhet të marrin pagë të plotë, përveç nëse ato vonojnë paarsyeshëm procedurat ose nuk bashkëpunojnë me hetimin. Një numër vendesh evropiane parashikojnë këtë lloj pezullimi por e lejojnë atë vetëm në raste të rralla dhe të jashtëzakonshme në lidhje me vepra të rënda disiplinore, ose kur vlerësohet e domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut në gjyqësor ose sistemin gjyqësor, ose kur një çështje penale është duke pritur kundër gjyqtar....”*

Akti i Sistemit Gjyqësor Austriak ka parashikuar se:

*“Autoriteti disiplinor mundet që pa seancë dëgjimore të imponojë pezullimin nga detyra të të pandehurit (gjyqtari / prokurori), nëse kjo është e nevojshme në interes të ushtrimit të detyrës ose për ruajtjen e reputacionit të statusit të gjyqtarëve / prokurorëve duke marrë parasysh natyrën ose ashpërsinë e tij për veprën penale për të cilën ai / ajo dyshohet.*

*Në raste urgjente, kryetari i gjykatës / prokurorisë mund të vendosë një pezullim paraprak. Në një rast të tillë, ai / ajo është i detyruar t'ia drejtojë çështjen organit kompetent disiplinor, i cili*

*pa vonesë do të dëgjojë organin e hetimit disiplinor dhe të vendosë për pezullimin. Me këtë vendim të autoritetit disiplinor kompetent, pezullimi paraprak shfuqizohet.”*

Dekreti Legjislativ Italian nr.109 i vitit 2006 parashikon që:

*“Kur magjistrati i nënshtrohet procedurës penale për një krim të dënueshëm të kryer jo me faj, ose kur të njëjtit mund t'i atribuohen faktet përkatëse nga pikëpamja disiplinore të cilat, për shkak të seriozitetit të tyre, janë të papajtueshëm me ushtrimin e funksioneve, Ministri i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm në Gjykatën e Kasacionit mund të kërkojnë Seksionin Disiplinor të Këshillit Suprem të Gjyqësorit për pezullim paraprak nga funksionet dhe pagat, dhe vendosjen jashtë rolit organik të magistraturës , edhe para fillimit të procedurave disiplinore.”*

Ligji Hollandez parashikon mundësinë e pezullimit nga detyra të magjistratit ndërmjet të tjerave kur ekziston një dyshim serioz për të supozuar se ekzistojnë fakte dhe rrethana që mund të çojnë në shkarkimin e gjyqtarit

Ndryshimi i nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vjen si nevojë e përcaktimit të hetimit disiplinor paraprak, që kryen Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119 të ligjit 96/2016, kur ka dyshim të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Dispozita parashikon se kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë krijon bindjen, se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për shkeljen e pretenduar i paraqet Këshillit përkatës, raport të arsyetuar për fillimin e një procedimi disiplinor dhe kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.

Argumentimi i parashtruar në Dekretin e Presidentit të Republikës se ky nen cënon parashikimet e nenit 140 të Kushtetutës, (dispozitë që parashikon rastet e pezullimit nga detyra të gjyqtarit me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor) dhe parimin e hierarkisë së akteve të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përbën një lexim të gabuar të normës ligjore jo në përputhje me frymën dhe qëllimin e saj.

Kjo dispozitë nuk parashikon në asnjë moment raste të tjera pezullimi për magjistratin, në mungesë të delegimit të shprehur të nenit 140 të Kushtetutës. Dispozita e propozuar është në përputhje me nenin 140 pika 3 të Kushtetutës trajton pezullimin për shkak të procedimit disiplinor, duke mos parashikuar raste te reja pezullimi, tej atyre të parashikuara nga Kushtetuta.

Nga ana tjetër neni 8 ofron edhe garancitë e nevojshme procedurale për të siguruar respektimin e procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës disiplinore të sanksionuar nga jurisprudenca e GJEDNJ pasi ka parashikuar:

Rastet që do të justifikojnë fillimin e procedurës së përshpejtuar të hetimit paraprak nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë të cilat lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se vazhdimi i magjistratit në detyrë dëmton rezultatin e procedimit

disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit.

- Krijimin e bindjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme.
- Paraqitjen e raportit të arsyetuar për fillimin e një procedimi disiplinor së bashku me kërkesën për pezullimin e magjistratit nga detyra.
- Të drejtën e magjistratit për të shprehur shpjegimet e tij përpara Këshillit, përpara se ky i fundit të vendosë për pezullimin e magjistratit nga detyra.
- Të drejtën e Këshillit për t'i kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

Të gjitha këto garanci procedurale sigurojnë një balance të drejtë dhe propocionale midis respektimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor nga njëra anë dhe mbrojtjes së interesit publik nga veprime dhe sjellje që çenojnë besimin e publikut në institucionet e drejtësisë dhe mosfunksionimin e shtetit të së drejtës nga ana tjetër.

**Në përfundim**, duke vlerësuar se nenet e kontestuara në dekretin nr. 11444, datë 02.03.2020, “Për kthimin e ligjit nr.15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” janë në përputhje me parimin e sigurisë juridike, parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit dhe mbajnë në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me **votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm** vendosi rrëzimin e Dekretit nr.11444, datë 02.03.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr. 15/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**RELATORE**

**KRYETAR**

**KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)**

**ULSI MANJA**